

PROCESVERBAL

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE
PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROKURIMIT: “Ndërtim i Godinës së Re Vendruajtja Shkozë”

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT : Punë ndërtimi
45000000-7

VLERA E FONDIT LIMIT: 224,149,746.23 (dyqind e njëzet e katër milion e njëqind e dyzet e e nëntë mijë e shtatëqind e dyzet e gjashtë pikë njëzet e tre) **lekë pa TVSH.**

**KOHEZGJATJA E KONTRATES/MARREVESHJES KUADER OSE AFATI PER ZBATIMIN E
SAJ : 16** (gjashtëmbëdhjetë) muaj kalendarikë.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor **Operatori i Blerje të Përqëndruara sh.a.** , ka hartuar procesverbalin për argumentimin e kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar.

Sipas parashikimeve ligjore për procedurat të cilat realizohen nga Organi Qëndror Blerës, Specifikimet Teknike ,Relacione , Projektet , Preventivi etj. dhe llogaritja e Fondit Limit përcillen nga Autoriteti Kontraktor perfituesi cili kërkon realizimin e punimeve.

KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8,*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme për sigurimin e ofertës mbështetet në Ligjin Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar), Neni 83, pika 1 si dhe në VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (e ndryshuar), Kreu V, Seksioni II, Neni 30, pika 1.

Kërkesa për Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit bazohet në Ligjin Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar), Neni 82 si dhe në VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (e ndryshuar), Kreu V, Seksioni II, Neni 26.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):

Kjo pikë përmbushet sipas pikës 1/a) të Kriterëve të Përgjithshme (Vetëdeklarimi sipas shtojcës 8)

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në Nenin 77, pika 1/a dhe pika 2, të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar); si dhe Kreu V, Seksioni III, Neni 39, pika 6, të VKM-së Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (e ndryshuar).

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Kopje të deklarimit të xhiros vjetore gjatë 3 (tri) viteve të fundit **financiare (2022, 2023, 2024)** lëshuar nga Autoriteti përkatës, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se vlera e përlllogaritur e kontratës. (Kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur nëse Operatori ekonomik arrin vlerën e xhiros minimale në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga Autoriteti Kontraktor).

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Kjo vlerë për xhiron vjetore është kërkuar pasi vlera e parashikuar e kontratës, është ndërmjet kufirit të lartë dhe të ulët monetar.

Shënim: Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e xhiros që mund të kërkohej, autoritetet/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të xhiros brenda këtij marzhi.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, si dhe kërkesave të ligjit Nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”.

AK në miratimin e këtij kriteri ka mbajtur në vëmendje nenin 29 të Ligjit Nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat tatimore”: “Çdo tatimpagues përgatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, duke paraqitur në të njëjtën kohë bilancin kontabël, së bashku me anekset e tij, si dhe çdo të dhënë tjetër të përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji.”

2.2.2 Për të vërtetuar një aktivitet pozitiv të qëndrueshëm Operatori ekonomik duhet të paraqesë Kopje të çertifikuara të balanceve të 3 (tri) viteve të fundit financiare **(2022, 2023, 2024)** të paraqitur në Autoritetet përkatëse Dega e Tatim Taksave të konfirmuara nga ky Autoritet si dhe të shoqëruara me Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabel të Autorizuar. (Kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur nëse në dy bilancet e njëpasnjëshme të kërkuara, nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit).

Shënim: Akt Ekspertiza e Ekspertit Kontabël të Autorizuar, duhet të paraqitet nga OE vetëm në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, gërma “c” të Ligjit nr. 10091, datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar”, i ndryshuar, ku parashikohet se: “Personat juridikë që detyrohen për auditimin ligjor të pasqyrave financiare detyrohen të kryejnë auditimin ligjor të pasqyrave financiare vjetore, përpara publikimit të tyre, nga eksperte kontabël ose shoqëri audituese: "c) shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar, të cilat zbatojnë për raportimin financiar standardet kombëtare të kontabilitetit, kur, në mbyllje të periudhës kontabël, për dy vite radhazi, tejkalojnë dy prej tre treguesve të mëposhtëm: i) totali i aktiveve të bilancit, në mbyllje të periudhës kontabël përkatëse, arrin ose e kalon shumën prej 50 milionë lekësh; ii) shuma e të ardhurave nga veprimtaria ekonomike (qarkullimi) në

atë periudhë kontabël arrin ose e kalon shumën prej 100 milionë lekësh; iii) ka, mesatarisht, 30 të punësuar gjatë periudhës kontabël”.

Kërkesa konsiderohet e përmbushur nëse në dy bilancet e njëpasnjëshme të kërkuara nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivit”.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, i ndryshuar si dhe nenin 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar për të vërtetuar një aktivitet pozitiv të qendrueshëm.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, si dhe kërkesave të ligjit Nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”. Referuar në nenin 29 të Ligjit Nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat tatimore: “Çdo tatimpagues përgatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, duke paraqitur në të njëjtën kohë bilancin kontabël, së bashku me anekset e tij, si dhe çdo të dhënë tjetër të përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji.

Ndërsa shoqërimi me Akt Ekspertizen e Ekspertit Kontabel të Autorizuar, është bërë duke iu referuar parashikimit në nenin 41 shkronja c” të Ligjit nr. 1009/2009: “*Personat juridikë që detyrohen për auditimin ligjor të pasqyrave financiare detyrohen të kryejnë auditimin ligjor të pasqyrave financiare vjetore, përpara publikim të tyre, nga ekspertë kontabël ose shoqëri audituese: "c) shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar, të cilat zbatojnë për raportimin financiar standardet kombëtare të kontabilitetit, kur, në mbyllje të periudhës kontabël, për dy vite radhazi, tejkalojnë **dy prej tre treguesve të mëposhtëm: i) totali i aktiveve të bilancit, në mbyllje të periudhës kontabël përkatëse, arrin ose e kalon shumën prej 50 milionë lekësh; ii) shuma e të ardhurave nga veprimtaria ekonomike (qarkullimi) në atë periudhë kontabël arrin ose e kalon shumën prej 100 milionë lekësh; iii) ka, mesatarisht, 30 të punësuar gjatë periudhës kontabël***”.

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për përvojën e mëparshme të ngjashme:

- a. Punë të ngjashme për një objekt të vetëm me vlerë jo më të vogël se **50%** e vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet konkretisht: **112,074,873.1** (njëqind e dymbëdhjetë milion e shtatëdhjetë e katër mijë e tetëqind e tridhjetë pikë një) lekë pa TVSH, të realizuar gjatë pesë viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.
- b. Punë të ngjashme deri në një kufi ku vlera monetare totale e punëve të kryera e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit është në një vlerë jo më të vogël sa dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet konkretisht: **448,299,492.5** (katërqind e dyzet e tetë milion e dyqind e nëntëdhjetë e nëntë mijë e katërqind e nëntëdhjetë e dy pikë pesë) lekë pa TVSH.

1. Vlerësimi i përvojës së suksesshme të Operatorit Ekonomik do të kryhet bazuar në deklaratat e dokumentat e mëposhtme:

- a) Për kontrata të realizuara me ente publike, Operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:
 - Formular vlerësimi për realizimin e punimeve sipas shtojcës Nr.9 (ku të përcaktohet qartazi vlera, afati i perfundimit të kontratës si dhe natyra e punës së kryer);

- Kontratë Sipërmarrje;
- Situacionin përfundimtar;
- Aktin e kolaudimit;
- Çertifikaten e marrjes ne dorezim/Çertifikatën e Përkohshme të marrjes ne dorezim.

Autoriteti/enti kontraktor, si dëshmi për përvojën e mëparshme, kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, për të vërtetuar përmbushjen e suksesshme të punëve.

Shënim : *Formulari i vlerësimit duhet të përcaktojë saktësisht cilësinë e kryerjes së punëve, dhe faktin nëse kontrata është realizuar me sukses.*

b) Për kontrata të realizuara me sektorin privat, Operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:

- Kontratë Sipërmarrje
- Situacionin përfundimtar;
- Fatura tatimore perkatese të deklaruara në organet tatimore.
- Aktin e kolaudimit;

Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, autoriteti/enti kontraktor kërkon si dëshmi, vërtetime, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, e shoqëruar me fatura tatimore dhe çdo lloj dokumenti tjetër, që parashikohet nga legjislacioni në fuqi, që provon realizimin me sukses të punëve.

Shënim : *Formulari i vlerësimit duhet të përcaktojë saktësisht cilësinë e kryerjes së punëve, dhe faktin nëse kontrata është realizuar me sukses.*

1.1 Per kontratat e realizuara si Bashkim Operatorësh, Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë: Kontratën e Bashkimit te operatoreve ekonomik si dhe prokurën e posacme të deklaruar në fazën e tenderimit.

1.2 Per kontratat e realizuara si Nënkontraktor, Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë: Kontratën bazë ndërmjet Kontraktorit dhe Autoritetit Kontraktor; si dhe Miratimi zyrtar si nënkontraktor i deklaruar nga ana e autoritetit kontraktor.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe nenit 39, pika 5 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që punët e mëparshme të ngjashme të jenë minimalisht në vlerën 50 % të vlerës së fondit limit, për një objekt të vetëm, ose jo më e vogël se dyfishi i vlerës limit që prokurohet për punët totale të ngjashme të kryera në 5 vitet e fundit, që janë brenda vlerave kufi të përcaktuara në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Pasi vlera e parashikuar e kontratës, është mbi kufirin e ulët monetar. Vlera për punë të ngjashme përbën një nivel të mjaftueshëm përvoja duke patur parashysh objektin dhe vlerën e kontratës.

Përvoja e mëparshme është element shumë i nevojshëm që garanton autoritetin, se operatorët ekonomikë mbi bazën e vlerës së punëve të ngjashme zotërojnë kapacitete për të zbatuar kontratën me sukses sipas një standarti të përshtatshëm cilësie. Në mbështetje të nenit 88 pika 1 e VKM 285/2021, parashikon se “Oferta mund të paraqitet nga një bashkim operatorësh ekonomikë, sipas përcaktimit të pikave 2 dhe 3, të nenit 14, të LPP-së, ku njëri prej të cilëve i përfaqëson të tjerët gjatë procedurës dhe, në rast përzgjedhjeje, edhe gjatë zbatimit të kontratës. Në ofertë duhet të përcaktohet pjesa e shërbimit, punës ose furnizimit, që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi nëpërmjet një kontrate bashkëpunimi të hartuar ndërmjet palëve.

2.3.2 Liçensa profesionale, lidhur me ekzekutimin e punëve të kontratës:

Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin licencën profesionale të shoqërisë, të vlefshme për zbatimin e punimeve objekt kontrate, të lëshuar nga Ministria e Infrastruktues dhe Energjise, në bazë të VKM nr. 42 datë 16.01.2008, *Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrijne veprimtari ndërtimi*” të ndryshuar, e cila perfshin kategorite e meposhtme:

Për punimet e përgjithshme në ndërtim :

- **NP-1A** Punime germimi ne toke
- **NP-2E** Ndërtime civile dhe industrial
- **NP-7A** Ujesjelles,kanalizime, vepra kullimi dhe vaditje
- **NP –12A** Punime të inxhinierisë së mjedisit.

Për punimet speciale të ndërtimit :

- **NS-1A** Punime për prishjen e ndërtimeve.
- **NS-2A** Impiante hidrosanitare, kuzhina, lavanteri, mirëmbajtja e tyre
- **NS-3A** Impiante ngritëse dhe transportuese (ashensorë, shkallë lëvizëse , transportues)
- **NS-4C** Punime rifiniture të muraturës dhe të lidhura me to, rifiniture me materiale druri, plastike, metalike dhe xhami dhe rifiniture të natyrës teknike ndërtuese.
- **NS-9A** Punime Strukturore Speciale
- **NS-12B** Impiante teknologjike ,termike dhe te kondicionimit
- **NS-14A** Impiante te brendshme elektrike,telefonike,radiotelefoni TV
- **NS-18A** Punime Topogjeodezike

Operatorët e huaj duhet të bëjnë ekuivalentimin e licensave profesionale që disponojnë të lëshuara nga vendi i origjinës, pranë Ministrisë së Infrastruktues dhe Energjisë, (ose

Ministrisë kompetente të kohës) Republika e Shqipërisë. (Rregullorja për kriteret dhe procedurat e dhënies së licensave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi, e miratuar me VKM- në, Nr.42, datë 16.01.2008). Mosparaqitja në këtë formë është kusht skualifikues.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 39, pika 6/a, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar si dhe Vendimin e Keshillit të Ministrave Nr. 42 datë 16.01.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licensave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”, i ndryshuar. Të dhënat për licencat e mësipërme janë vendosur referuar bazës ligjore për ndërtimet, ligjit nr. 8402 datë 10.9.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit” të ndryshuar, neni 8 përcakton "Zbatimi i punimeve të ndërtimit kryhet vetëm nga persona juridikë, privatë ose publikë, vendas ose të huaj, të pajisur me licencën përkatëse, për zbatim punimesh ndërtimore. Zbatuesi i punimeve mban përgjegjësi dhe është i detyruar të realizojë punimet e ndërtimit, në përputhje me lejen e ndërtimit, projektin, kushtet teknike të zbatimit dhe rregullat e sigurimit teknik. Ai duhet të sigurojë cilësinë e materialeve të ndërtimit dhe produkteve të ndërtimit, të cilat duhet të plotësojnë kërkesat e projektit në përputhje me standartet kombëtare ose europiane. Referuar kategorive të kërkuara, AK argumenton teknikisht se kjo kërkesë është vendosur sipas zërave të preventivit të punimeve.

-Kategoritë janë kërkuar bazuar në zërat dhe vlerat e punimeve, si më poshtë:

Kategoria e kërkuar	Përshkrimi i kategorisë sipas legjislacionit të fushës	Zërat e punimeve që parashikohen të kryhen në preventiv, që përfshihen në kategorinë përkatëse	Niveli i klasifikimit i kërkuar për kategorinë respektive
NP 1 A	Punime gërmimi në toke	Gërmim dheu me ekskavator goma 0.25 m ³ , në kanale gjeresi deri 2 m, toke zak, kategoria III, me shk në toke Transport materiale ndërtimi, dheu me auto deri 10.0 km Gërmim e mbushje dheu me krah kat III për themele, h=1.5m Gërmim dheu themele e plinta me b>2m, ekskavator me zinxhir 0.5m ³ , shkarkimi në auto Transport materiale ndërtimi, dheu me auto deri 10.0 km Gërmim dheu themele e plinta me b>2m, ekskavator me zinxhir 0.5m ³ , shkarkimi në auto etj	A (0- 20 milionë lekë)
NP-2E	Ndërtimie civile dhe industriale	Mure b/a t = 11-20cm h ~ 4m C 16/20 Trare e arkitrare b/a C16/20 h ~ 4m Plinta e bazamente b/a monolite deri 20m ³ C 16/20 F V hekur betoni periodik Ø 6 - 10 mm F V hekur betoni periodik Ø > 12 mm Nenshtrese zhavori Shtrese betoni C 12/15 Nenshtrese zhavori Shtrese betoni C 16/20 Shtrese betoni C 16/20 Shtrese betoni C 7/10 Shtrese lluster cemento 1:2 Shtrese me pllaka porcelanat Shtrese betoni C 7/10 Shtrese lluster cemento 1:2 Shtrese me pllaka grez importi, 40x40cm Shtrese me pllaka grez importi, 40x40cm Shtrese lluster cemento 1:2 Shtrese me pllaka graniti t=3cm Shtrese me pllaka graniti t=3cm Shtrese me pllaka graniti t=2cm Shtrese betoni C 16/20 Struktura të holla monolite betoni C 16/20	E (201- 400 milionë lekë)

		Struktura monolite betoni C 20/25 StruPllake themeli, trare e bazamente b/a C 30/37 Themel e xokol betoni C - 16/20 Mure b/a t = 21-30cm, h ~ 4m C 30/37 (Xokoli) Mure b/a t = 21-30cm, h ~ 4m C 30/37 Kollona b/a monolite C 30/37 h ~ 4m Trare b/a C30/37 h ~ 4m Soleta te ploti b/a C 30/37 t = 10 cm Soleta te ploti b/a C 30/37 t = 10 cm, h ~ 4m shkallet Shtrese betoni C 20/25 dysHEMEJE Mur buto betoni C 16/20 Mur buto betoni C 16/20kura monolite betoni C 16/20 etj	
NP-7 A	Ujësjetllës, ,kanalizime, vepra kullimi e vaditje.	Pusete shiu 40 x 40, h = 100 cm, me kapak zgare hekuri Pusete shkarkimi 80 x 80, h = 100 cm Puse kont 1.25x1.25x1,5m FV pusete plastike 40x40x40, kapak te forte RIC 1084+1086 F V tuba te brinjezuar HDPE SN8 d=800 mm F.V Tub shkarkimi e rakorderi PP Ø 110 mm Pusete b/a shiu 50 x 50 cm, h = 100 cm, me kapak zgare hekuri F.V Tuba PVC f=300 mm te brinjezuar FV Tuba e rakorderi ujesjellesi PPR d=40mm, Pn 16 FV Tuba e rakorderi ujesjellesi PPR d=20~25mm, Pn 25 F.V Tuba PVC Ø 400 mm per linja te jashtme etj	A (0- 20 milionë lekë)
NP-12A	Punime të inxhinierisë së mjedisit.	Punimet per ndertimin e objektit kane impakt mjedisor ne te gjithë zonen perreth saj duke pasur parasysh pozicionimin e saj ne zone e banuar urbane , sasine e madhe te mbetjeve te gjeneruara nga punimet e prishjeve dhe germimeve , për menaxhimin e punime të ujrave të ndotura etj duke ju permbajtur VNM .	A (0- 20 milionë lekë)
NS-1A	Punime per prishjen e ndertimeve .	Prishje kollona, trare b/a Prishje mur tulle pa pastrim Cmontim kapriate ekzistuese etj	A (0- 20 milionë lekë)
NS-2A	Implante hidro-termosanitare dhe mirëmbajtja e tyre.	F.V lavaman porcelani F.V WC allafrenga FV Tuba e rakorderi ujesjellesi PPR d=20~25mm, Pn 25 F.V pilete dysHEMEJE Ø 50 F.V Tuba çeliku i zi F.V, tub flesibel 1/2" l=400 mm F.V, Saracineske mini 1/2" F.V, Mates uji 1 1/4" F.V Kolektor shpendares 3/4" (5+5) F.V Tub shkarkimi e rakorderi PP Ø 50 mm F.V. Kundravalvula Ø 2" etj	A (0-20 milionë lekë)
NS-3A	Implante ngritëse dhe transportues (ashensorë, shkallë lëvizëse, transportues).	F.V Ashensor mallrash deri ne 450 kg, me dy ndalesa, sistem hidraulik, te dorezuar ne gjendje pune.	A (0-20 milionë lekë)
NS-4C	Punime rifiniture të muraturës dhe të lidhura me to, rifiniturë me materiale druri, plastik, metalik dhe xhami dhe rifiniturë të natyrës teknike ndërtuese.	Mur me tulla te lehtësuara dopio deri 8 m, LL.P. M-25 Mur me tulla te lehtësuara deri - 3 m, LL.P. M-25 Shtresë termoizoluese me lesh guri t=10cm në taracë H/izolim me 2 l ruberoid 4mm e zakonshme Shtrese betoni me kuarc F.V. davanciale graniti t=2cm (tek pjesa e brendshme e dritares) F.V. davanciale llamarine të lyer me bojë për dritaret, parapetet e daljet në mure me gjerësi 27cm F.V. davanciale llamarine të lyer me bojë për parapetin e taracës me gjerësi 41cm F.V. element dekorativë metalik në fasadë, të trajtuar me antindryshk dhe të lyer me bojë vaji Suvatim fasade me mbrojtje termike me sistem kapotë me 8cm lesh guri Tavane të varur me gips, rezistent ndaj zjarrit F.V. vetratë e dritare PVC me 3 xhama (xhami I jashtëm, xham termik), me mbushje me gaz F.V. derë e blinduar metalike, antizjarr me veshje	C (51-100 milionë lekë)

		llamarinë Lyerje tavanesh e muresh të brendshëm e të jashtëm me bojë plastike antimyk F.V dyer metalike llamarine Parapet shkalle e ballkone me tuba inoksi ngjyre e verdhe ose metalizato h = 80 ~ 90 cm Ulluk shkarkimi vertikal me llamarine xingat Ø 100 Ulluk shkarkimi horizontal me llamarine xingat 33cm Kasete shkarkimi me llamarine xingat Hidroizolim me emulsion bitumi dhe 1 k katrama ETJ.	
NS-9A	Punime Strukturore Speciale	Struktura te holla monolite betoni C 16/20 Struktura monolite betoni C 20/25 Struktura monolite betoni C 16/20 Mur buto betoni C 16/20 etj	A (0-20 milionë lekë)
NS-12B	Impiante teknologjik , termik dhe te kondicionimit	Elemente montimi dhe mberthimi (upa, fasheta, prixhionere, profile metalike, stafa, bulloneri, upa metalike betoni, Gur fleksibel, Boje antiruxho, boje te kuqe Ral 3000, teflone, ngjites etj.) "V. Pompe nxehtesie e tipit ""ajer / uje"" Me rekuperim nxehtesie, e kompletuar me kitin hidraulik.Kapaciteti ftohes / ngrohes ne temperaturen -1°C/35°C : --- 130 / 140 kW . Temp. te jasht. vere/dimer : 35°C / -1°C : ---- 23000 l/h Fuqia elektrike / tensioni / intensiteti/ushqimi : 60 kW / 400V /125 A / 3 F ~ 50Hz. Kit hidraulik (akumulator, ene zgjerimi, pompe riqarkullimi, valvol, etj..). Grup furnizimi automatik, sensore komplet, dhe mbrojtje automatike kunder ngrirjes. Kompletuar me strukture metalike mbeshtetese me amortizator. Dimens. A x B x H : 2650 x 2258 x 2221 mm.Pesha 1600 kg" V. Fancoil kasete 4-rruge, I pajisur me filter G1, sensor ajri ne kthim, me valvol te motorrizuar 3 rrugeshe, ... - 1.54 kW. I pajisur me kontrollouesin dhe ndërfaqen e përdoruesit, me menaxhuesin e opsioneve te motorrit dhe kombinuesin e kursimit te energjise V. Fancoil kasete 4-rruge, I pajisur me filter G1, sensor ajri ne kthim, me valvol te motorrizuar 3 rrugeshe, ... - 2.21 kW. I pajisur me kontrollouesin dhe ndërfaqen e përdoruesit, me menaxhuesin e opsioneve te motorrit dhe kombinuesin e kursimit te energjise V. Fancoil kanalor, I pajisur me filter G1, sensor ajri ne kthim, me valvol te motorrizuar 3 rrugeshe ... - 2.82 kW. I pajisur me kontrollouesin dhe ndërfaqen e përdoruesit, me menaxhuesin e opsioneve te motorrit dhe kombinuesin e kursimit te energjise V. Fancoil kanalor, I pajisur me filter G1, sensor ajri ne kthim, me valvol te motorrizuar 3 rrugeshe ... - 5.1 kW I pajisur me kontrollouesin dhe ndërfaqen e përdoruesit, me menaxhuesin e opsioneve te motorrit dhe kombinuesin e kursimit te energjise "V. Pompe qarkullimi per AHU Nr. 1, 2 dhe 3 Karakteristikat Teknike :- Fuqia e instaluar : 2x0.55 kW, - Intensiteti i rrymës : 2x2 A, - Tensioni i dhenë : 3F~ 400V 50Hz - Prurja: 6.9 m³/h - Prevalenca: 7.0 mkH2O - Lidhjet: DN 32/PN 10 " "V. Pompe qarkullimi per AHU Nr. 4 Karakteristikat Teknike : - Fuqia e instaluar : 2x0.75 kW, - Intensiteti i rrymës : 2x2 A, - Tensioni i dhenë : 3F~ 400V 50Hz - Prurja: 10.3 m³ / h - Prevalenca: 8 mkH2O	B (21-50 milionë lekë)

		- Lidhjet: DN 40/PN 10" "V. Pompe qarkullimi (per instalimet Fan-coil) Karakteristikat Teknike : - Fuqia e instaluar : 2x0.75 kW, - Intensiteti i rrymës : 2x2 A, - Tensioni i dhenë : 3F~ 400V 50Hz - Prurja: 9.52 m³/h - Prevalenca: 9.0 mkH2O - Lidhjet: DN 40/PN 10" "V. Pompe qarkullimi (per pompat e nxehtesise) Karakteristikat Teknike :- Fuqia e instaluar : 2x3.0 kW, - Intensiteti i rrymës : 2x6 A, - Tensioni i dhenë : 3F~ 400V 50Hz - Prurja: 22.37 m³/h - Prevalenca: 9 mkH2O - Lidhjet: DN 65/PN 10" "V. Pompe qarkullimi (per pompat e nxehtesise) Karakteristikat Teknike : - Fuqia e instaluar : 2x0.75 kW, - Intensiteti i rrymës : 2x2.1 A, - Tensioni i dhenë : 3F~ 400V 50Hz - Prurja: 9.45 m³ / h - Prevalenca: 8 mkH2O - Lidhjet: DN 32 / PN 10" "V. Akumulator (Ndares hidraulik) DN 100 - Presioni max : 10 bar - Temperatura e ambientit: 5°C- 50°C - Prurja max. : 28.0 m³/h - Permasat: 1279 x 526 mm - Kapaciteti 3000L" "V. Ndares i kombinuar per ajrin - Presioni max. i pranueshem, PS: 12 bar - Presioni minimal i pranueshem, PSmin: 0 bar - Temperatura max. e pranueshme 160°C - Temperatura min. e pranueshme -10°C - Dimensionet : D= 168 H=626 L=350 mm - Lidhjet : DN 65" "V. Ndares i kombinuar per llumin - Presioni max. i pranueshem, PS: 12 bar - Presioni minimal i pranueshem, PSmin: 0 bar - Temperatura max. e pranueshme 160°C - Temperatura min. e pranueshme -10°C - Dimensionet : D= 168 H=626 L=350 mm - Lidhjet : DN 65" "V. Ene zgjerimi per pompen e nxehtesise se ujit te ngrohje sanitare - Volumi 300 liter - Diameter 580 mm - Lartesia 1200 mm - Presioni max 6 bar - Temperatura e punes 99°C - Lidhja 1/2" " "V. Njesi e trajtimit te Ajrit (Nr. 1, 2, 3): Prurja e ajrit dergim/kthim ---- 8000 / 7500 m³/h . Renia e presionit te jashtem dergim/kthim ---- 350/250 Pa. Kapaciteti termik ne ngrohje / ftohje ---- 30 kW/ 40 kW. Kapaciteti termik i pas ngrohjes ---- 30 kW. Fuqia elektrike e ventilatorit, dergim 11kW/3 F 400V/50Hz /kthim 7.5kW 3 F /400V/50Hz. i kompletuar me inverter shpejtesie. Komplet filtrash, komplet kuader elektrik, set sensoresh, rregullator klimaterik, set i valvolave 3 kalimshe per baterite. Struktura e tipit te jashtem. Dimensionet AxBxH [mm]: 1460x770x3380. Pesha 1781 kg)." "V. Njesi e trajtimit te Ajrit AHU Nr.4 : Prurja e ajrit dergim/kthim ---- 16800 / 15550 m³/h . Renia e presionit te jashtem dergim/kthim ---- 350/250 Pa. Kapaciteti termik ne ngrohje / ftohje. 80. kW/ 130.0 kW.
--	--	---

		Kapaciteti termik i pas ngrohjes ---- 40kW. Fuqia elektrike e ventilatorit, dergim 30 kW/3 F400V/50Hz /kthim 11kW 3 F/400V/50Hz. i kompletuar me inverter shpejtesie. Komplet filtrash, komplet kuader elektrik, set sensoresh, rregullator klimaterik, set i valvolave 3 kalimshe per baterite. Struktura e tipit te jashtem.Dimensionet AxBxH [mm]: 2110 x 8870 x 3680. Pesha 5650 kg. " "V. Ndares i kombinuar per ajrin -Presioni max. i pranueshem, PS: 12 bar - Presioni minimal i pranueshem, PSmin: 0 bar -Temperatura max. e pranueshme 160°C - Temperatura min. e pranueshme -10°C - Dimensionet : D= 168 H=626 L=350 mm - Lidhjet : DN 65 " etj	
NS-14A	Impiante të brendshme elektrike, telefonike, radiotelefoni TV.	F.V. Elektroda tokezimi, profil zingato e bakerizuar , L=1.5m F.V. Percjelles Tokezimi , Cu, S=35mm2, i zhveshur F.V kuti suport pllaket 2 mod F.V kuti suport pllaket 4 mod F.V Çeles 1 polar 220V 10A F.V priza shuko brenda murit 2 fazore 25 A F.V.ne toke kablllo Cu fuqie ÷1000V, me izolim gome e mbulese plastmasi, te armuar, 3x95+50mm2 F.V Percjelles FeZn Ø10 F.V Morsete kryq universale F.V Percjelles bakri I zhveshur Ø25 me aksesori perkates F.V Shkeputes per matje tokezimi me aksesori perkates + kuti jashte murit per fiksim ne mur F.V Zbarre ekuipotenciale 50x40 per tokezim me aksesori perkates F.V Shtize Rrufepritesi 1 m me aksesori perkates F.V Shtize 2 ml me aksesori perkates dhe koke thithese rrufepritese F.V Kanaline metalike 150x75mm e zinkuar me kapak dhe aksesori perkates F.V Kanaline metalike 200x75mm e zinkuar me kapak dhe aksesori perkates F.V Kthesa kanaline metalike 90° plan 150x75 mm e zinkuar me kapak dhe aksesori perkates F.V Kthesa kanaline metalike 90° plan 200x75 mm e zinkuar me kapak dhe aksesori perkates F.V Degezim T plan kanaline metalike 150x75 mm e zinkuar me kapak dhe aksesori perkates F.V Degezim T plan kanaline metalike 200x75 mm e zinkuar me kapak dhe aksesori perkates F.V Zbritje vertikale 90° tip hinke kanaline metalike150x75mm e zinkuar me kapak dhe aksesori perkates F.V Zbritje vertikale 90° tip hinke kanaline metalike 200x75mm e zinkuar me kapak dhe aksesori perkates F.V Tub flex d20 - i zi me aksesori perkates F.V Tub flex d25 - i zi me aksesori perkates F.V Tub plastik i guajne d20 F.V Tub plastik i guajne d25 F.V Kuti celsa/priza 3mod F.V Kuti celsa/priza 4mod F.V Tape fallco plastike 1mod F.V Kuti shperndarese ne kanaline IP 66 100x100mm F.V Percjelles bakri 2,5 mm² N07-Vk F.V Kabell FROR 450/750V flex 3x1.5 mm² F.V Kabell FROR 450/750V flex 3x2.5 mm² F.V Kabell FG7OM1 06/1KV flex 3x1.5 mm² F.V Kabell FG7OM1 06/1KV flex 3x2.5 mm² F.V Kabell FG7OM1 06/1KV flex 3x4 mm² F.V Kabell FG7OM1 06/1KV flex 3x6 mm²	A (0-20 milionë lekë)

		F.V Kabell FG7OM1 06/1KV flex 5x16 mm² F.V Kabell FG7OM1 06/1KV flex 5x4 mm² V.Ndricues panel LED 45 W,60x60 cm,4000K,3600lm V.Ndricues fluoreshent 1x18W; 5000K,IP55 V.Ndricues plafonier LED 18W, Ø22.5cm, 4000K V.Sensor levizje V.Ndricues spot reflektor 30W 3000K, 3600lm, 120°,Ø22 V.Ndricues spot reflektor 20W 3000K, 2400lm, 120°,Ø18 V.Ndricues emergjence 1x8w, 220V, 4 ore autonomi V.Ndricues evakuimi me shenje dalje 1x8w, 220V, 2 ore autonomi F.V Tub flex I rende d20 me aksesori perkates V. Rack 42U I Kompletuar Me Priza, Ventilatore, Cable Guide, V. Panel Patch me 24 Port (sipas specifikimeve) V.Switch 24 Port (sipas specifikimeve) Patch Cord 1.5m F.V Prize telefoni Rj 11 4p F.V Prize rrjeti Rj 45 8p F.V Kabell telefonie 2 kopie 2x2x0.6 mm² F.V Kabell rrjeti wlan FTP Cat 6 4x2xawg23/1 F.V Tub flex i rende d20 - I zi me aksesori perkates V. Detektor te adresueshem tymi 10-30V,IP43 V.Sirene alarmi e jashtme IP42 V.Sirene alarmi e brendshme IP30 V.Buton me xham te thyeshem V.Central alarmi I adresueshem V.Bateri 12 V F.V Kabell per sinjalizimi zjarri FG40HM1 S=2x0.8 mm² F.V.Tub plastik rigid djegie pa flake dhe emetim gazi Ø=16mm F.V Kuti shperdarese J/M PT2 F.V Drejtim dalje emergjence (AL-5107-B) V. Gjenerator me motorr Perkins me celes ATS (Automatic Transfer Switch) dhe me panel kontrolli, 50kVA, 50Hz, Presioni i Zhurmes: 70dB F.V Pusete betoni me kapak 50x50x100 me kapak gize,(sipas specifikimeve ne projekt) F.V Kabell bakri FG7OR 0.6/1kV flex. (3x35+1x25)mm² - furnizimi nga gjeneratori F.V Tub korregato D90 F.V Panel metalik 168mod me dere kristali F.V Llamb sinjalizimi 3 led 230V (kuqe) F.V Shkarkues mbitesioni 4P 80kA F.V Automat mag/ter diferencial 4P C40A 6kA 30mA F.V Automat mag/ter 4P 250A 6kA F.V Automat mag/ter 4P 80A 6kA F.V Automat mag/ter 4P 40A 6kA F.V Automat mag/ter 4P 25A 6kA F.V Automat mag/ter 4P 16A 6kA F.V Automat mag/ter 1P+N 16A 6kA F.V Automat mag/ter 1P+N 10A 6kA F.V Automat mag/ter 1P+N 6A 6kA F.V. NVR 32 KANALE F.V. NVR 16 KANALE F.V.Hard Disk 10 TB F.V. IP Kamera të Jashtme + aksesori F.V. IP Kamera të Brendshme + aksesori F.V. Rack 16U F.V. Rack 8U F.V. Monitorë 24" F.V. Pach Panel F.V. Switch PoE 24 port F.V. Switch PoE 16 port F.V. Fibër Optike F.V. Media Konvertet për kamerat	
--	--	---	--

		F.V. Media Konvertet për në sallën e monitorimit Tub mbrojtës për kabllot e fibrës V. UPS 3F, 10kVA, 10 min autonomi F.Ndricues panel LED 45 W,60x60 cm,4000K,3600lm F.Ndricues fluoreshent 1x18W; 5000K,IP55 F.Ndricues plafonier LED 18W, Ø22.5cm, 4000K F.Sensor levizje F.Ndricues spot reflektor 30W 3000K, 3600lm, 120°,Ø22 F.Ndricues spot reflektor 20W 3000K, 2400lm, 120°,Ø18 F.Ndricues emergjence 1x8w, 220V, 4 ore autonomi F.Ndricues evakuimi me shenje dalje 1x8w, 220V, 2 ore autonomi F. Detektor te adresueshem tymi 10-30V,IP43 F.Sirene alarmi e jashtme IP42 F.Sirene alarmi e brendshme IP30 F.Buton me xham te thyeshem F.Central alarmi I adresueshem F.Bateri 12 V F. Rack 42U I Kompletuar Me Priza, Ventilatore, Cable Guide, F.Panel Patch me 24 Port (sipas specifikimeve) F.Switch 24 Port (sipas specifikimeve) F. Gjenerator me motorr Perkins me celes ATS (Automatic Transfer Switch) dhe me panel kontrolli, 50kVA, 50Hz, Presioni i Zhurmes: 70dB F. UPS 3F, 10kVA, 10 min autonomi etj	
NS 18A	Punime topogjeodezike	Punime matje volume dhe piketimi te elementeve b/a si : soleta , pllak themeli , kollona , muret rrethueses te objektit , muret mbajtese, matjen e te gjitha ketyre objekte ne gjatesi dhe ne lartesi ,rilevimi i terrenit ku do realizohet muri dhe sistemimet e jashtme etj.	A (0- 20 milionë lekë)

2.3.3 Operatori ekonomik duhet të përcaktojë me anë të një deklarate Drejtuesin Teknik të punimeve në objekt, i cili duhet të jetë i përfshirë në liçencën e shoqërisë, dhe të deklarojë se nuk është i angazhuar në kontrata të tjera dhe do të jetë i pranishëm gjatë gjithë kohës që do të kryhen punimet në objekt, të figurojë në listpagesat e shoqërisë minimumi për 3 (tre) muajt e fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave shoqëruar me dokumentacionin e mëposhtme:

- Kontratë pune e vlefshme;
- Diplomë.
- C.V (përkatese)

Shënim: Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për tu kërkuar sqarime nga AK.

Argumentimi: Së pari, kjo kërkesë mbështetet në Ligjin Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar), Neni 77, pika 4, si dhe në VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (e ndryshuar), Kreu V, Seksioni III, Neni 39, pika 6, gërma “c”.

Së dyti, duke qenë se objekt prokurimi është kontratë pune sqarojmë se detyrimin për prezencën e Drejtuesit Teknik gjatë gjithë kohës që do të kryhen punimet në objekt e përcakton qartazi Udhëzimi Nr.2, datë 13.05.2005 “ Për zbatimin e punimeve të ndërtimit”, konkretisht pika 1.2 ku citohet se: “drejtuesit ligjore dhe teknik të sipërmarrësit janë përgjegjës përpara investitorit për ndërtimin e veprës, sipas projektit, për

kryerjen e punimeve të ndërtimit, në përputhje me kushtet teknike të zbatimit, specifikimet teknike, sigurimin teknik dhe mbrojtjen në punë, brenda kushteve të kontratës e dispozitave ligjore në fuqi” si dhe pikës 2.1 ku citohet se “drejtimi teknik i punimeve në kantier sigurohet, sipas rastit, drejtpërdrejtë nga drejtuesi teknik i sipërmarrësit ose përgjegjësi teknik i kantierit.

Lidhur me kërkesën që Drejtuesi Teknik i punimeve në objekt duhet të jetë i përfshirë në licencën e shoqërisë dhe të mos jetë i angazhuar në kontrata të tjera, mbështetet në Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 42, datë 16.1.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”, pika 2 ku përcaktohet se: “Papajtueshmëritë me detyrën e drejtuesit teknik të shoqërisë së zbatimit Drejtuesit teknikë të shoqërisë nuk mund të jenë personat që janë të angazhuar në çdo punë-marrje tjetër publike. Drejtuesi teknik i shoqërisë nuk mund të jetë njëkohësisht i punësuar në dy apo më shumë shoqëri ndërtimi dhe ndalohej të disponojnë licencë për mbikëqyrje e kolaudim të punimeve të zbatimit” dhe pika 2: “elementët e licensës” gërma “c” ku citohet se: “Licencat e shoqërive jepen me afat të njëjtë me atë për të cilin janë regjistruar për të ushtruar veprimtari në QKR apo gjykatë. Ndalohej ushtrimi i veprimtarisë zbatuese në ndërtim në mungesë të drejtuesit/ve teknikë të shoqërisë. Shoqëritë e licencuara jo më vonë se 10 ditë kalendarike, kur drejtuesi teknik është dorëhequr ose ka pamundësi fizike për ushtrimin e detyrës (aksident, sëmundje me paaftësi ushtrimi detyre mbi 14 ditë, invaliditet, ndarje nga jeta), kanë detyrimin të paraqesin njoftim së bashku me kërkesën për drejtuesin e ri teknik të shoqërisë”.

Për sa më lart, çdo kërkesë e renditur për Drejtuesin Teknik, buron nga kontrata e punës objekt prokurimi, me qëllim përmbushjen dhe realizimin e saj sipas kushteve dhe dispozitave ligjore në fuqi.

2.3.4 Një punësim minimalisht prej **110 (njëqind e dhjetë) punonjës**, të cilët duhet të figurojnë në listpagesat e shoqërisë minimumi për 3 muajt e fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave vërtetuar me:

- a. Vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore për **3 muajt** e fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave.
- b. Listpagesat e punonjesve të konfirmuara nga autoritetet perkatese sipas formatit që kerkohet nga legjislacioni në fuqi për **3 muajt** e fundit të deklaruar.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar dhe nenit 39, pika 6/ç dhe 6/d, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë minimale punëtore, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

Në përcaktimin e numrit të punonjësve specialisti i fushës ka bërë një analizë bazuar tek faktorët, si volumet dhe kategoritë e punimeve, kualifikimi i punonjësve, grafiku i punimeve, zërat e punimeve dhe orët e punës dhe pagën minimale të lejuar që duhen për të përmbushur kontratën. Numri i punonjësve dhe qëndrueshmëria e tyre në punë me kohështrirje tre mujore nga data e zhvillimit të tenderit, tregon besueshmëri për autoritetin që, operatori do të përmbushë kontratën. Dëshmia e kërkuar për numrin e fuqisë punëtore të operatorit ekonomik e nevojshme për ekzekutimin e objektit të kontratës, është dokument që vërteton kapacitetin teknik dhe profesional të operatorit, për sa kohë janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës. Deklarimi dhe regjistrimi i punonjësve në regjistrin e sigurimeve është një detyrim ligjor i punëdhënësit e parashikuar nga Kodi i Punës, për rrjedhojë vërtetimi i lëshuar nga administrata tatimore e shoqëruara me listpagesat me këtë kohështrirje është dokument vërtetues për qëndrueshmërinë e të punësuarve, përvojën e tyre, dhe janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës. Punësimi i një numri të caktuar, përveç besueshmërisë së operatorëve ekonomik, si një nga kërkesat themelore të kualifikimit, përpiket të kufizojë edhe problematikat sociale dhe shmangien e informalitetit në tregun e punës. Po ashtu është një tregues i kualifikimit dhe eksperiencës që duhet të ketë kjo kategori e punonjësve. Vendosija e kriterit për një punësim të paktën 110

punonjes duke përfshirë dhe stafin teknik, është në përputhje me volumin e punës, natyrën e punimeve. Kriteri për kualifikim është vendosur që t'i shërbejë autoritetit për të njohur gjendjen e kapaciteteve të operatorëve të cilët nëpërmjet dokumentacionit të vërtetojnë se zotërojnë, kapacitetet teknike dhe profesionale, personelin e nevojshëm, si dhe kapacitetet organizative, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

Analizat teknike janë bazuar në VKM Nr. 216, datë 13.04.2023 “ *Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre*”. Bazuar në këto elementet e strukturës së kostos (material, puntori, makineri, transport).

(Numri i punonjësve, i mjeteve/makinerive që nevojiten për realizimin e kontratës është përcaktuar bazuar në ligjin Nr. 8402 datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar dhe akteve nënligjore)

Në mënyrë të përmblodhur numri i fuqisë punëtore që kërkohet për realizimin e punimeve është min **110 punonjës**.

2.3.5 Operatorët ekonomik pjesëmarrës duhet të kenë të punësuar staf inxhinierik për kryerjen e të gjitha punimeve në objekt, të përfshirë në licencën e shoqërisë, të vërtetuar me kontratë pune të vlefshme, CV, diplomë përkatëse si dhe të figurojnë në listat e shoqërisë për **3 muajt** e fundit të deklaruara nga data e hapjes së ofertave, konkretisht:

- **1 (një) Inxhinier Ndërtimi**
- **1 (një) Inxhinier Ndërtimi profili Strukturist**
- **1 (një) Inxhinier Ndërtimi profili Gjeoteknik**
- **1 (një) Inxhinier Elektrik**
- **1 (një) Inxhinier Mjedis**
- **1 (një) Inxhinier Mekanik**
- **1 (një) Inxhinier Hidroteknik**
- **1 (një) Inxhinier Topograf/Gjeodet/Markshejder**
- **1 (një) Inxhinier Gjeolog**
- **1 (një) Inxhinier Elektronik/IT/Telekomunikacion**
- **1 (një) Arkitekt**

Shënim: Kjo kërkesë përmblodhet nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmblodhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8 të DST.

Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afatit të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për të kërkuar sqarime nga AK.

Argumentimi: AK argumenton se kërkesa për stafin inxhinierik është vendosur sipas përcaktimeve të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, Neni 77, pika 4, si dhe në VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar Kreu V, Seksioni III, Neni 39, pika 6, germa “c”.

Kriteri për stafin drejtues teknik, lidhet ngushtësisht me objektin e kontratës, relacionin teknik dhe zërat e punimeve. Nevoja për inxhinierët në objekt është e diktuar nga përvoja dhe legjislacioni për punimet e ndërtimit. Mungesa e këtij stafi do të rezultojë në çdo rast rezultim jashtë afatit, jashtë normave dhe me cilësi të dobët të objekteve. Numri i stafit kryesor teknik si numri i inxhinierëve të ndërtim, hidroteknik, etj është përcaktuar nga pikëpamja e natyrës teknike të kontratës me qëllimin për të patur një rezultat sa më

të mirë në mbarëvajtjen dhe zbatimin e punimeve. Operatorët ekonomikë duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën. Drejtues teknik është përgjegjës për ndërtimin në përputhje me kushtet teknike të zbatimit, sigurimin teknik dhe mbrojtjen në punë brenda kushteve të kontratës. Bazuar në parashikimet e mësipërme të legjislacionit për prokurimin publik, Autoriteti Kontraktor ka kërkuar që operatori ekonomik ofertues duhet të ketë në stafin e tij **drejtues teknik** të cilët kanë një rol të rëndësishëm në mbarëvajtjen e punimeve pasi ata janë përgjegjës për zbatimin e objektit sipas projektit dhe në përputhje me kushtet teknike të zbatimit të tij.

Kërkesa specifike për Inxhinierët e kërkuar është përcaktuar në kuadër të analizës teknike që i është bërë Preventivit të Punimeve (nga ku përcaktohet qartazi dhe profili inxhinierik) si dhe në bashkrendim me kategoritë e kërkuara në Licencën profesionale të shoqërisë sipas pikës 2, kapaciteti teknik në DST. Duke marrë në konsideratë Projektin e zbatimit si dhe Preventivin e Punimeve rezulton se është e domosdoshme që çdo Ofertues të ketë pjesë të stafit Inxhinierë të kërkuar si me siper, të cilët në bashkëpunim me njëri tjetrin si dhe me fuqinë punëtore të shoqërisë do të realizojnë me sukses kontratën objekt prokurimi.

Lidhur me kërkesën që Drejtuesit Teknik të punimeve në objekt duhet të jetë i përfshirë në licencën e shoqërisë mbështetet në Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 42, datë 16.1.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”, pika 2 ku përcaktohet se: “Papajtueshmëritë me detyrën e drejtuesit teknik të shoqërisë së zbatimit Drejtuesit teknikë të shoqërisë nuk mund të jenë personat që janë të angazhuar në çdo punë-marrje tjetër publike. Drejtuesi teknik i shoqërisë nuk mund të jetë njëkohësisht i punësuar në dy apo më shumë shoqëri ndërtimi dhe ndalohej të disponojnë licencë për mbikëqyrje e kolaudim të punimeve të zbatimit” dhe pika 2: “elementët e licensës” gërma “c” ku citohet se: “Licencat e shoqërive jepen me afat të njëjtë me atë për të cilin janë regjistruar për të ushtruar veprimtari në QKB apo gjykatë. Ndalohej ushtrimi i veprimtarisë zbatuese në ndërtim në mungesë të drejtuesit/ve teknikë të shoqërisë. Shoqëritë e licencuara jo më vonë se 10 ditë kalendarike, kur drejtuesi teknik është dorëhequr ose ka pamundësi fizike për ushtrimin e detyrës (aksident, sëmundje me paafësi ushtrimi detyre mbi 14 ditë, invaliditet, ndarje nga jeta), kanë detyrimin të paraqesin njoftim së bashku me kërkesën për drejtuesin e ri teknik të shoqërisë”.

Duke marrë në konsideratë Projektin e zbatimit si dhe Preventivin e Punimeve rezulton se është e domosdoshme që çdo Ofertues të ketë pjesë të stafit Inxhinierë të kërkuar, të cilët në bashkëpunim me njëri tjetrin ,stafin mbështetes si dhe me fuqinë punëtore të shoqërisë do të realizojnë me sukses kontratën objekt prokurimi.

- **Arkitekt** është përgjegjës për zbatimin e saktë të punimeve arkitekturore sipas projektit arkitektonik.
- **Inxhinieri i Ndërtimit** është përgjegjës për zbatimin e saktë të punimeve objekt kontrate për të gjithë zërat e punimeve ndërtimore sipas parashikimeve në projekt-preventiv.
- **Inxhinier Ndërtimi profili Strukturist** është përgjegjës për zbatimin e saktë të punimeve objekt kontrate për të gjithë zërat e punimeve ndërtimore, sipas parashikimeve në projektin konstruktiv.
- **Inxhinier Ndërtimi profili Gjeoteknike** është përgjegjës për zbatimin e saktë të punimeve objekt kontrate për të gjithë zërat e punimeve ndërtimore, sipas parashikimeve në projektin konstruktiv.
- **Inxhinieri Elektrik** është përgjegjës për zbatimin e saktë të punimeve elektrike lidhur me zërat e punimeve të parashikuara në projekt-preventiv.
- **Inxhinieri Hidroteknik** është përgjegjës për zbatimin e saktë të punimeve hidroteknike lidhur me zërat e punimeve të parashikuara në projekt-preventiv.
- **Inxhinieri Mekanik** është përgjegjës për zbatimin e saktë të punimeve mekanike, referuar punimeve të parashikuara në projekt-preventiv.
- **Inxhinier Topograf/ Gjeodet/Markshajder** është përgjegjës për zbatimin e saktë të punimeve që përfshin kuota dhe piketime lidhur me punimet e parashikuara në projekt-preventiv.

- **Inxhinier Gjeolog** është përgjegjës për vlerësimin e kushteve gjeologjike të zonës ku do të ndërtohet objekti.
- **Inxhinier Elektronik/IT/Telekomunikacion** është përgjegjës për zbatimin e saktë të punimeve elektronike lidhur me zërat e punimeve të parashikuara në projekt-preventiv.
- **Inxhinier Mjedis** është përgjegjës për zgjidhjen e problemeve mjedisore për mbrojtjen e mjedisit lidhur me punimet e parashikuara në projekt-preventiv.

2.3.6 Operatori ekonomik për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë edhe staf (jo domosdoshmërisht drejtues teknik në licencën e shoqërisë), si më poshtë:

- **1 (një) Inxhinier Ndertimi**
- **1 (një) Inxhinier Hidroteknik**
- **1(një) person, i certifikuar si Specialist Për Testimin e Performances së Materialeve/Produkteve të Ndërtimit /Inxhinier Materialesh**

Kriteri konsiderohet i përmbushur me vetëdeklarimin sipas Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës perkatese të DST, “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari dorëzimin e dokumenteve provuese”.

*Për secilin pjesëtar të stafit të mësipërm duhet të paraqesë: Kontratë pune e vlefshme, Diplomë, Librezë pune dhe C.V si edhe të figurojë në listëpagesat e shoqërisë për **3 muajt** e fundit.*

Shënim: Kjo kërkesë përmbushet nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8 të DST.

Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për tu kërkuar sqarime nga AK.

Argumentimi: AK argumenton se kërkesa për stafin inxhinierik është vendosur sipas përcaktimeve të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, Neni 77, pika 4, si dhe në VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar Kreu V, Seksioni III, Neni 39, pika 6, germa “c”.

Kriteri për stafin e mësipërm, lidhet ngushtësisht me objektin e kontratës, relacionin teknik dhe zërat e punimeve. Nevoja për inxhinierët në objekt është e diktuar nga përvoja dhe legjislacioni për punimet e ndërtimit. Mungesa e këtij stafi pothuajse në çdo rast rezulton në realizim jashtë afatit, jashtë normave dhe me cilësi të dobët të objekteve. Numri i stafit kryesor teknik si numri i inxhinierëve të ndërtim, hidroteknik, etj është përcaktuar nga pikëpamja e natyrës teknike të kontratës me qëllimin për të patur një rezultat sa më të mirë në mbarëvajtjen dhe zbatimin e punimeve. Operatorët ekonomikë duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën

Kërkesa specifike për Inxhinierët e kërkuar jo domosdoshmërisht të përfshirë në licencën e shoqërisë është përcaktuar në kuadër të analizës teknike që i është bërë Preventivit të Punimeve (nga ku përcaktohet qartazi dhe profili inxhinierik) si dhe në bashkrendim me kategoritë e kërkuara në Licencën profesionale të shoqërisë sipas pikës 2, kapaciteti teknik

në DST. Duke marrë në konsideratë Projektin e zbatimit si dhe Preventivin e Punimeve rezulton se është e domosdoshme që çdo Ofertues të ketë pjesë të stafit Inxhinierë të kërkuar si me siper, të cilët në bashkëpunim me njëri tjetrin si dhe me fuqinë punëtore të shoqërisë do të realizojnë me sukses kontratën objekt prokurimi.

Kriteri konsiderohet i përmbushur me vetëdeklarimin sipas Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës nr. 8. Formulari i vetëdeklarimit duhet të përmbajë kërkesat e autoritetit. Autoriteti/enti kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari, dorëzimin e dokumenteve provuese.

2.3.7 Operatorët ekonomik pjesëmarrës duhet të kete si staf mbështetës (me kontrate pune/ kontratë bashkëpunimi) si më poshtë:

- a) 1 (një) specialist Ekspert Zjarrfikës në fushën e mbrojtjes nga zjarri dhe për shpëtimin në përputhje me klauzolat Ligjit Nr. 152/2015 "Per sherbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe per shpetimin", Neni 49, pika 4. Rekomandohet të jete ne kantier per minizimin e aksidenteve ne pune.
- b) 2(dy) persona të pajisur me certifikaten e Trajnimit për “Punime në prani/prezence uji”, e dhëne nga nje organizëm i licencuar/certifikikuar shqiptar ose i huaj. Duke u bazuar sipas zërave të preventivit, projektit konstruktiv dhe të zbatimit.
- c) 1 (një) punonjës me çertifikatë "Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë" në përputhje me klauzolat e Ligjit Nr. 10327 datë 18/02/2010 "Për sigurinë dhe shëndetin në punë" dhe V.K.M Nr. 312, date 05.05.2010 "Për miratimin e rregullores "Për sigurinë në kantier"." Rekomandohet të jete ne kantier per minizimin e aksidenteve ne pune.
- d) 1 (një) punonjës i pajisur me çertifikate “Ekspert për ndihmën e parë dhe ndërhyrjen ndaj emergjencave” e cila të jetë e lëshuar nga Kryqi i Kuq ose shoqeri të akredituara ose nga organizma ndërkombëtare akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë. Rekomandohet të jete ne kantier ne rast aksidentesh ne pune

Për punonjësit e mësipërm Operatori Ekonomik duhet të paraqesë:

- Kontratat individuale të punës (të vlefshme).
- Diplomë/Çertifikatë

Shënim: Kjo kërkesë përmbushet nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8 të DST.

Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për tu kërkuar sqarime nga AK.

Argumentimi : Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/c), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës.

Kërkesa e mësipërme mbështet në ligjin Nr. 10327 datë 18/02/2010 “Për sigurinë dhe shëndetin në punë” dhe V.K.M nr. 312, datë 05.05.2010 “Për miratimin e rregullores “Për sigurinë në kantier”. Natyra e kontratës dhe specifikat e sajë kërkojnë njohuri e përgatitje të posaçme për vlerësime të përpikta për të zgjidhur çështje që lidhen me garantimin e sigurisë dhe mbrojtjen në punë. Në rregulloren për sigurinë në kantier miratuar me VKM nr.312/2010 është përcaktuar se punëdhënësi për mbrojtjen dhe parandalimin

nga rreziqet, duhet të ndjekë kurse formimi përkatës në fushën e sigurisë e të shëndetit në vendin e punës. Çdo punëdhënës zgjedh një ose disa persona si përgjegjës për ndihmë e parë në rast emergjencash dhe për sigurinë e mbrojtjen e shëndetit. Rregullorja përcakton kërkesat minimale të sigurisë dhe të shëndetit në punë për kantieret e përkohshëm ose të lëvizshëm, si dhe masat e përgjithshme të mbikëqyrjes.

- 1 (një) specialist Ekspert Zjarifikës në fushën e mbrojtjes nga zjarri dhe për shpëtimin rekomandohet të jetë në kantier për marrjen e masave të menjehershme në rastet e zjarreve në kantier
- 2(dy) persona të pajisur me certifikatën e Trajnimit për “Punime në prani/prezenca uji”, rekomandohen të jenë në kantier për kryerjen e punimeve në prezenca uji.
- 1 (një) punonjës me certifikatë "Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë" rekomandohet të jetë në kantier për trajnimin e punonjesve të kantierit me qëllim minimizimin e aksidenteve në punë.
- 1 (një) punonjës i pajisur me certifikatë “Ekspert për ndihmën e parë dhe ndërhyrjen ndaj emergjencave” rekomandohet të jetë në kantier për ndërhyrje në raste aksidentesh.

2.3.8 Operatori ekonomik duhet të ketë të punësuar staf teknik për kryerjen e punimeve, të vertetuar me kontratë punë të vlefshme, një dokument që të vërtetojë kualifikimin profesional (dëshmi kualifikimi profesional/certifikatë/diplomë), lëshuar nga institucione (shtetërore apo private) të licencuara/akredituara nga autoritetet përgjegjëse shtetërore, sipas ligjit nr. 15/2017 “Për arsimin dhe formimin profesional në Republika e Shqipërisë”. Dëshmi të Sigurimit Teknik lëshuar nga ISHTI ose nga një trup certifikues akredituar nga DPA ose nga organizmat ndërkombëtarë akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë, si dhe të figurojnë në listat e shoqërisë për 3 muajt e fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave, si më poshtë:

STAF TEKNIK	
Teknik Ndërtimi	2
Teknik IT/Elektronik	2
Hidraulik	3
Elektricitet	3
Instalues dhe riparues të sistemeve ngrohje-ftohje	3
Hekurkthyes	6
Karpentier	6
Punonjës i izolimeve (Hidroizolues)	3
Betonues	5
Murator/Suvatues	5
Pllakashtrues	3
Specialist gipsi	3
Punonjës për dritare	3
Bojaxhi	5
Specialist veshje fasade	3
Specialist ndërtimi (për punime të përgjithshme)	3
Specialist të certifikuar për "Punime në lartësi"	4

Eskavatorist	4
Shofer	5
Automakinista	5

2.3.8/1 Për punonjesit eskavatorist/ automakinist/shofer, ofertuesi duhet të paraqesë:

- a) kontratë individuale të punës;
- b) leje drejtimi, certifikate e aftesimit profesional (CAP) për shoferet dhe dëshmi aftesimi profesional (DAP) për manovratorët-automakinistët/eskavatoristët, që të vërtetojë kualifikimin profesional të kërkuar, referuar rregullores “Për kushtet, kriteret dhe programet për përgatitjen teoriko-praktike të kandidatëve, si dhe dhënien e Dëshmisë së Aftësisë Profesionale për përdoruesit e makinerive të rënda për punime ndërtim dhe toke, si dhe disiplinimi i përdorimit të tyre”, miratuar me urdhërin nr. 200, datë 16.5.2019, të Ministrit të Infrastrukturës dhe Energjitikës.

(Në rastin kur punonjësit Manovrator/shofere janë të kontraktuar me kontratë pune (respektivisht për mjetet e marra me qera), nuk kërkohet të figurojnë në listpagesat e shoqërisë).

Shënim: Kjo kërkesë përmbushet nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8 të DST. Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për tu kërkuar sqarime nga AK.

Argumentimi: Kjo kërkesë mbështetet në Ligjin Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, Neni 77, pika 4, si dhe në VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” I ndryshuar, Kreu V, Seksioni III, Neni 39, pika 6, gërma “ç”. Qëllimi i vendosjes së këtij kushti është i implementuar sipas dispozitave ligjore dhe shërben si një garanci që kontrata objekt prokurimi do të realizohet me sukses sipas Specifikimeve Teknike (të cilat do publikohen së bashku me Dokumentat e Tenderit) si dhe punimet do të kryhen brenda afatit kohor të parashikuar në Njoftimin e Kontratës. Sqarojmë se, të gjithë specialistët e kërkuar janë në përputhje të plotë me projekt-preventivin duke marrë në konsideratë volumet e punes që do të realizohen, si dhe kohëzgjatjen e tyre. Autoriteti Kontraktor domosdoshmërisht duhet të garantohet që këto punime do të kryhen nga persona të kualifikuar dhe me eksperiencë të mjaftueshme, për zbatimin e këtyre punimeve sipas standarteve të percaktuara në specifikimet teknike. Zbatimi i punimeve që përfshin projektin duhet të kryhet nga fuqi punëtore e kualifikuar për secilën tipologji punimesh. Për të vërtetuar kualifikimin e stafit teknik është kërkuar që të jenë të pajisur me dokument që të vërtetojë kualifikimin profesional (dëshmi kualifikimi profesional/ certifikatë/diplomë), lëshuar nga institucione (shtetërore apo private) të licencuara/akredituara nga autoritetet përgjegjëse shtetërore, sipas ligjit nr. 15/2017 “Për arsimin dhe formimin profesional në R.Sh.”. Mbështetur në këtë legjislacion certifikimet profesionale ofrohen nga institucione të licensuara nga Ministria përkatëse nëpërmjet Agjencisë Kombëtare të Arsimit, Formimit Profesional. Certifikatat e këtyre specialisteve duhet të jenë të regjistruara në “regjistrat profesionale” të AKAFP-se. Percaktimi i numrit të punonjesve dhe profesionet është bazuar mbi zërat dhe volumet e punes si dhe afateve për perfundimin e punimeve, në mbështetje të të cilave janë bazuar në VKM nr. 216, datë 13.4.2023 “Për krijimin dhe funksionimin e sistemit të integruar përinformatizimin e manualit të çmimeve për zërat e punimeve në ndërtim”. Bazuar në kriter elementet e strukturës së kostos (material, puntori, makineri, transport). Numri i punonjësve, dhe profesionet që nevojiten për realizimin e kontratës është përcaktuar bazuar në ligjin Nr. 8402 datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar dhe akteve nenligjore.

2.3.9 Deklaratë e ofruesit për modelin, kompaninë prodhuese, për mallrat e paisjet që do të vendosen në objekt sipas tabelës së mëposhtme:

Nr.	Emërtimi i pajisjes/materialeve	Modeli	Kompania prodhuese, Web, E-mail, Nr. kontakti
1	F.Pompe nxehtesie e tipit "ajer / uje" Me rekuperim nxehtesie, e kompletuar me kitin hidraulik.Kapaciteti ftohes / ngrohes ne temperaturen -1°C/35°C : --- 130 / 140 kW . Temp. te jasht. vere/dimer : 35°C / -1°C : ---- 23000 l/h Fuqia elektrike / tensioni / intensiteti/ushqimi : 60 kW / 400V /125 A / 3 F ~ 50Hz. Kit hidraulik (akumulator, ene zgjerimi, pompe riqarkullimi, valvol, etj..). Grup furnizimi automatik, sensore komplet, dhe mbrojtje automatike kunder ngrirjes. Kompletuar me strukture metalike mbeshtetese me amortizator. Dimens. A x B x H : 2650 x 2258 x 2221 mm. Pesha 1600 kg		
2	F.Pompe qarkullimi per AHU Nr. 1, 2 dhe 3 Karakteristikat Teknike :- Fuqia e instaluar : 2x0.55 kW, - Intensiteti i rrymës : 2x2 A, - Tensioni i dhenë : 3F~ 400V 50Hz - Prurja: 6.9 m³/h - Prevalenca: 7.0 mkH2O - Lidhjet: DN 32/PN 10		
3	F.Pompe qarkullimi per AHU Nr. 4 Karakteristikat Teknike : - Fuqia e instaluar : 2x0.75 kW, - Intensiteti i rrymës : 2x2 A, - Tensioni i dhenë : 3F~ 400V 50Hz - Prurja: 10.3 m³ / h - Prevalenca: 8 mkH2O - Lidhjet: DN 40/PN 10		
4	F.Pompe qarkullimi (per instalimet Fan-coil) Karakteristikat Teknike : - Fuqia e instaluar : 2x0.75 kW, - Intensiteti i rrymës : 2x2 A, - Tensioni i dhenë : 3F~ 400V 50Hz - Prurja: 9.52 m³/h - Prevalenca: 9.0 mkH2O - Lidhjet: DN 40/PN 10		
5	F.Pompe qarkullimi (per pompat e nxehtesise) Karakteristikat Teknike :- Fuqia e instaluar : 2x3.0 kW, - Intensiteti i rrymës : 2x6 A, - Tensioni i dhenë : 3F~ 400V 50Hz - Prurja: 22.37 m³/h - Prevalenca: 9 mkH2O		

	- Lidhjet: DN 65/PN 10		
6	F.Pompe qarkullimi (per pompat e nxehtesise) Karakteristikat Teknike : - - Fuqia e instaluar : 2x0.75 kW, - Intensiteti i rrymës : 2x2.1 A, - Tensioni i dhenë : 3F~ 400V 50Hz - Prurja: 9.45 m³ / h - Prevalenca: 8 mkH2O - Lidhjet: DN 32 / PN 10		
7	F.Njesi e trajtimit te Ajrit (Nr. 1, 2, 3) : Prurja e ajrit dergim/kthim ---- 8000 / 7500 m³/h . Renia e presionit te jashtem dergim/kthim ---- 350/250 Pa. Kapaciteti termik ne ngrohje / ftohje ---- 30 kW/ 40 kW. Kapaciteti termik i pas ngrohjes ---- 30 kW. Fuqia elektrike e ventilatorit, dergim 11kW/3 F400V/50Hz /kthim 7.5kW 3 F /400V/50Hz. i kompletuar me inverter shpejtesie. Komplet filtrash, komplet kuader elektrik, set sensoresh, rregullator klimaterik, set i valvolave 3 kalimshe per baterite.Strukture e tipit te jashtem. Dimensionet AxBxH [mm]: 1460x7705x3380. Pesha 1781 kg).		
8	F.Njesi e trajtimit te Ajrit AHU Nr.4 : Prurja e ajrit dergim/kthim ---- 16800 / 15550 m³/h . Renia e presion te jashtem dergim/kthim ---- 350/250 Pa. Kapaciteti termik ne ngrohje / ftohje. 80. kW/ 130.0 kW. Kapaciteti termik i pas ngrohjes ---- 40kW. Fuqia elektrike e ventilatorit, dergim 30 kW/3 F400V/50Hz /kthim 11kW 3 F/400V/50Hz. i kompletuar me inverter shpejtesie. Komplet filtrash, komplet kuader elektrik, set sensoresh, rregullator klimaterik, set i valvolave 3 kalimshe per baterite. Strukture e tipit te jashtem.Dimensionet AxBxH [mm]: 2110 x 8870 x 3680. Pesha 5650 kg.		
9	Hekur betoni periodik		
10	Tuba te brinjezuar HDPE SN8 d=800 mm		
11	Vetratë e dritare PVC me 3 xhama (xhami I jashtëm, xham termik), me mbushje me gaz		

2.3.9/a Për pajisjet/materialet e tabelës së dhënë në pikën 2.3.9, Operatori ekonomik duhet të paraqesë autorizim nga prodhuesi ose distributori i autorizuar, me të cilin prodhuesi ose distributori i autorizuar, autorizon kompaninë pjesëmarrëse në tender të ofertojë këto pajisje/materiale. Në rast paraqitje autorizim distributori autorizuar, duhet të paraqitet kontrata ose dokumenti i angazhimit midis prodhuesit dhe distributorit, për materialet kryesore te kerkuara.

2.3.9/b Të paraqiten katalogët nga prodhuesi/prodhuesit apo distributorit të autorizuar nga prodhuesi, për të gjitha paisjet/materialet sipas pikës 2.3.9. Në katalogë, duhet të markohet me ngjyrë të qartë pajisja/materiali që ofrohet dhe të pasqyrohen specifikimet teknike të kërkuara për këto pajisje/materiale.

Fleta ose fletët e katalogut që pasqyrojnë specifikimet teknike të kërkuara të pajisjes/materialeve, duhet të paraqiten në gjuhën shqipe, të përkthyer dhe noterizuara.

2.3.9/c OE të paraqesë një deklaratë, ku merr përsipër të garantojë instalimin si dhe servisin e pajisjeve gjatë periudhës së garancisë (2 vite), për defektet që vijnë nga prodhimi i tyre.

Argumentimi : Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, nenin 39, pika 8, si dhe në bazë të nenit 45, pika 1 të VKM-së Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar.

Në preventivin e punimeve ka një numër të madh zërash që janë furnizim vendosje pajisje dhe nisur nga pesha specifike si në sasi dhe në vlerë që këto zëra zënë në preventive. AK e ka parë të domosdoshme kërkimin e autorizimit të prodhuesit për të garantuar cilësinë e pajisjeve për nga vetë rendesia që ka ky objekt. Kërkesa e këtij dokumenti që ne kete faze krijon një lehtësi për Autoritetin Kontraktor pasi ne kete mënyrë siguron cilësinë, specifikimet teknike të këtyre pajisjeve e cila është lehtësisht e kontrollueshme gjatë fazës së zbatimit në reference me dokumentat e paraqitura që gjatë kualifikimit. Nepermjet dorezimit të këtij dokumentacioni që ne fazën e vlerësimit asnjë OE ekonomik nuk i shmanget dot detyrimit që gjatë zbatimit të furnizojë të njëjtin mall të certifikuar nga KVO.

Kjo kërkesë është kërkuar që t’i sigurojë Autoritetit Kontraktor që operatori ekonomik ka kapacitetin e nevojshëm teknik dhe plotëson specifikimet e kërkuara nga projektuesit për zbatimin në kohë dhe cilësi të kontratës për këtë objekt. Për të krijuar bindjen e autoritetit kontraktor për aftësitë teknike, aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur të operatorëve ekonomik fitues potencialë dhe realizimin me sukses të kontratave, njësia e prokurimit vlerëson se operatorët ekonomikë duhet të paraqesin autorizim nga prodhuesi/distributori, me të cilin prodhuesi/ distributori autorizon kompaninë pjesëmarrëse në tender të ofertojë pajisjet dhe mallrat e nevojshme në këtë procedurë prokurimi. Duke qenë se materialet e kërkuara prodhohen në mënyrë industriale, certifikimi nga prodhuesi mbi parametrat e tyre është i domosdoshëm.

Duke marrë shkas nga tipologjia e objektit të prokurimit dhe nga punimet/shërbimet që parashikohen të realizohen në preventive si dhe për shkak të interesit të lartë që ka objekti duhet të garantohej që mallrat kryesore të jenë sipas standardeve më të mira europiane, është gjykuar të domosdoshme të garantohej që mallrat kryesore të jenë sipas standardeve më të mira europiane, që OE ka aftësi të mjaftueshme për të realizuar me sukses dhe cilësi kontratën, duke furnizuar brenda kohës së përcaktuar vetëm pajisje origjinale me garanci, si dhe i shërben Autoritetit Kontraktor për të bërë krahasueshmërinë e materialeve të ofruara nga operatori me ato të kërkuara në dokumentat e tenderit. Për të siguruar këtë gjë, por njëkohësisht dhe për të detyruar ofertuesit e mundshëm në zbatimin e këtyre standardeve ka parashikuar kërkesën e mësipërme, vetëm për disa nga mallrat kryesorë me qëllim që do të përdoren në këtë objekt dhe konkretisht OE duhet të japin dhe paraqesin në mënyrë të detajuar karakteristikat teknike të mallrave të përfshirë në dokumentat e tenderit, karakteristikat këto që duhet të përputhen me specifikimet teknike të kërkuara nga projektuesi. Me anë të venies në dispozicion në fazën e ofertimit dokumentat si autorizim-marreveshje angazhimi, kataloge, ofertuesi garanton Autoritetin Kontraktor se mallrat që do të furnizojë do të jenë prodhim sipas kërkesave të projektit. Plotësimi i kërkesës me sipër garanton Autoritetin Kontraktor për cilësinë dhe standartet e larta ndërkombëtare dhe të përditësuara sipas teknologjisë së re dhe bashkëkohore.

2.3.10 Operatori ekonomik duhet të paraqesë grafikun e punimeve të detajuar sipas zërave të preventivit (Bashkëlidhur DST) të shprehur në afatin kohor të përcaktuar në dokumentat e tenderit për **16 (gjashtëmbëdhjetë) muaj kalendarike**.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në Nenin 79 të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, Nenin 39, pika 3 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

2.3.11 Operatori ekonomik duhet të kenë kontratë noteriale më një **laborator testimi të betonit**, i cili duhet të jetë i akredituar nga organizma kombëtar ose ndërkombëtar sipas standarteve **SSH EN 12350-2:2019, SSH EN 12504-2:2021, SSH EN ISO 6892 – 1:2019, SSH EN 12390-8:2019.**

Argumentimi: AK argumenton se kërkesa për një **laborator testimi të betonit**, i cili duhet të jetë i akredituar nga organizma kombëtar ose ndërkombëtar është vendosur sipas përcaktimeve të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, Neni 77, pika 4, si dhe në VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar Kreu V, Seksioni III, Neni 39, pika 2 dhe 4.

2.3.12 Operatori ekonomik duhet të paraqesë certifikatat si më poshtë:

- a) Certifikatën e cilësisë së punimeve **SSH/EN/UNI ISO 9001-2015** e përditësuar, e vlefshme/ose/ekuivalent. Certifikata të jetë lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.
- b) Certifikatën për Sistemin e menaxhimit të mjedisit **SSH/EN/UNI ISO 14001-2015** e përditësuar, e vlefshme /ose/ ekuivalent. Certifikata te jetë lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.
- c) Certifikatën **SSH/ EN/UNI ISO 45001:2018** e përditësuar, (**SSH/EN/UNI ISO 45001 – 2023**) e vlefshme/ ose ekuivalent (Mbi Sistemet e menaxhimit të shendetit dhe sigurisë të punëtorëve në punë ose ekuivalent). Certifikata te jetë lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.
- d) Certifikatën **SSH/EN/UNI ISO 50001-2018**, e përditësuar, e vlefshme/ ose ekuivalent (Sistemi i Menaxhimit të Energjisë e vlefshme ose ekuivalent). Certifikata te jetë lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik, Operatori ekonomik do te paraqese ISO-t në baze te zerave te punimeve qe ka marre persiper te realizoje.

Pranohet dhe paraqitja e standardeve shqiptare **SSH/EN/UNI** mbi komformitetin e standardeve europiane dhe të lëshuara nga organizma të vlerësimit të konformitetit të akredituara në Republikën e Shqipërise.

Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër, ose t'i kërkojë operatorit sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime, në përputhje me nenin 26, pika 7, të VKM nr.285, datë 19.05.2021, “Për Miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik

Argumentim: Kërkesat e cilësisë të përcaktuara sipas pikës 2.3.10 gërma “a”- “d” janë vendosur në mbështetje të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar), Neni 79, pika 1 ku citohet se: *“Autoriteti ose enti kontraktor për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë”,* si dhe ne zbatim të Neni 44, pika 1 dhe pika 3 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, ku përcaktohet se: *“Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit”*.

ISO 9001:2015 është një seri normash dhe standartizimesh ndërkombëtare, që i referohen sistemeve të menaxhimit të cilësisë, pra, të strukturave të organizimit të ndërmarrjeve publike dhe private, struktura të cilat këto ndërmarrje duhet t’i adoptojnë për një orientim më të mirë të ndërmarrjes në standartet e tregut. AK gjykon se çdo Ofertues duhet të jetë i pajisur me ISO 9001:2015 me qëllim efektivitetin dhe efektshmërinë në zhvillimin e veprimtarisë së tij, e cila do të sjellë dhe zvogëlimin e kostove. Pra ky certifikim do të bëjë të mundur që Ofertuesit të ofrojnë cilësi të mirë me çmime të ulta.

ISO 14001:2015 ofron një kuadër praktik për shoqëritë që duan të menaxhojnë rreziqet mjedisore ekzistuese dhe potenciale. Ky sistem integrohet lehtësisht në strukturën e menaxhimit të biznesit për të kontrolluar impaktet që aktivitetet, operacionet, produktet dhe shërbimet kanë mbi mjedisin. AK gjykon se çdo Ofertues duhet të jetë i pajisur me ISO 14001:2015 me qëllim që veprimtaria e ushtruar nga ana e tij (në rastin konkret realizimi i punës objekt prokurimi) të identifikojë impaktin në mjedis gjatë aktivitetit të saj si dhe të përmirësojë performancën mjedisore duke zbatuar një qasje sistematike. Pra ky certifikim do të bëjë të mundur që Ofertuesit të ushtrojnë veprimtarinë duke pasur në konsideratë parimin e mbrojtjes së mjedisit.

ISO 45001-2018/45001-2023 është standard ndërkombëtar, i cili parashtrohet kërkesat për menaxhimin e praktikave të mira të sigurisë dhe shëndetit në punë për çdo organizatë, pavarësisht nga madhësia. AK gjykon se çdo Ofertues duhet të jetë i pajisur me ISO 45001-2018 me qëllim që veprimtaria e ushtruar nga ana e tij (në rastin konkret realizimi i punës objekt prokurimi) të realizohet duke u mbështetur mbi parimin e sigurisë dhe shëndetit në punë. Kjo kërkesë shërben dhe si një garanci extra që do të sjellë reduktimin e aksidenteve dhe sëmundjeve në vendin e punës duke minimizuar kostot si dhe kohën në përmbushjen me sukses të kontratës së punës objekt prokurimi.

ISO 50001-2018 është standard ndërkombëtar, i cili specifikon kërkesat e përgjithshme për krijimin e një Sistemi të Menaxhimit të Energjisë në një organizatë dhe fokusohet në identifikimin e mundësive për përmirësimin e performancës së energjisë. ISO 50001 përcakton synimet dhe objektivat specifike për kursimin e energjisë, të cilat arrihen përmes programeve për menaxhimin e energjisë dhe monitorimin sistematik të variablave të energjisë.

Në VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (e ndryshuar), Kreu XI, Neni 88, pika 3, cilësohet se: “Secili prej anëtarëve të këtij bashkimi duhet të përmbushë kërkesat e parashikuara në nenin 76 të LPP dhe ato të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Kërkesat për kualifikim ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në akt marrëveshje”.

Për sa më lart, Njësia e Prokurimit, gjykon se, kjo kërkesë në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik duhet të përmbushet nga Shoqëria e cila referuar Marrëveshjes së Bashkëpunimit ka marrë përsipër të realizojë zerat e parashikuara sipas Preventivit.

AK gjykon se kërkesa për pajisjen e Ofertuesve me Çertifikatat e kërkuara sipas pikës 2.3.12 gërma “a”- “d”, është brenda kuadrit të parashikuar nga legjislacioni për prokurimin publik. Çertifikatat e kërkuara janë në përpjestim me objektin e kontratës dhe respektojnë natyrën e punimeve.

2.3.13. Operatori Ekonomik duhet te disponoje:

Licence te leshuar nga Qendra Kombetare e Biznesit (QKB) Kodi III.2.B (Për grumbullim dhe transport të mbetjeve inerte dhe të ngurta), së bashku me aktin e miratimit, në përputhje me parashikimet e vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 538, datë 26.5.2009 “Për licencat dhe lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet Qendrës Kombëtare të Licencimit (QKL) dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta”, i ndryshuar, e shoqëruar me Aktin e Miratimit.

Certifikatat duhet të jenë të vlefshme në kohën e zhvillimit të tenderit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 39, pika 6/a, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar, si dhe në nenin 4, pika e 1/b e ligjit nr. 10448, datë 14.7.2011 “Për lejet e mjedisit” i ndryshuar, ku parashikohet se: “leja e mjedisit e tipit B është e detyrueshme për kryerjen e veprimtarive të kategorisë B, lista dhe praqjet përkatëse të të cilave janë përcaktuar në shtojcën 1/B të këtij ligji”.

Në shtojcën 1/B është listuar edhe veprimtaria “Menaxhimi i mbetjeve”.

Në nenin 57/2 të ligjit nr. 10463, datë 22.9.2011 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”, i ndryshuar, parashikohet se: “Qendra Kombëtare e Licencimit lëshon licencën **për transportin e mbetjeve**, e cila përfshihet në nënkategorinë III.2.B të fushës III të vendimit nr. 538, datë 26.5.2009 të Këshillit të Ministrave “Për licencat dhe lejet që trajtohen nga/apo nëpërmjet Qendrës Kombëtare të Licencimit (QKL) dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta”, pas miratimit të saj nga ministri”.

Ndërkohë, sipas VKM nr. 538, datë 26.5.2009 “Për licencat dhe lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet qendrës kombëtare të licencimit (qkl) dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta”: “Veprimtaria e nënkategorisë III.2.B specifikohet në veprimtari të tilla si grumbullim, transportim, ruajtje, riciklim, përpunim apo asgjësim i mbetjeve të llojeve të ndryshme”.

2.3.14 Dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo mund ti vihen në dispozicion operatorit ekonomik, që nevojiten për ekzekutimin e kontratës (Shtojca 8) konkretisht:

Nr	Emri i mjetit	Njesi	Sasi/cope	Statusi
1	Kamion kapaciteti mbajtës min 20 ton	copë	3	Në pronësi ose me qera
2	Kamion kapaciteti mbajtës 10 -20 ton	copë	3	Në pronësi ose me qera
3	Kamion kapaciteti mbajtës 3.5- 5 ton	copë	2	Në pronësi ose me qera
4	Kamionçine kapaciteti mbajtës min 1.5 ton	copë	1	Në pronësi ose me qera
5	Dumper kantieri	copë	1	Në pronësi ose me qera
6	Fadrome me goma	copë	2	Në pronësi ose me qera
7	Eskavator me goma	copë	2	Në pronësi ose me qera
8	Eskavator me zinxhire	copë	2	Në pronësi ose me qera
9	Autobetoniere	copë	4	Në pronësi ose me qera
10	Autopompe betoni / Pompe betoni	copë	1	Në pronësi ose me qera

11	Minieskavator	copë	1	Në pronësi ose me qera
12	Mini Fadrome/ Bobcat	copë	1	Në pronësi ose me qera
13	Telehender/Auto-Ngrites hidraulik	copë	1	Në pronësi ose me qera
14	Kamion me vinc	copë	1	Në pronësi ose me qera
15	Rimorkiator / Karrotrec	copë	1	Në pronësi ose me qera
16	Rrul me vibrim	copë	2	Në pronësi ose me qera
17	Grejder	copë	1	Në pronësi ose me qera
18	Cekiç Hidraulik	copë	1	Në pronësi ose me qera
19	Elektroorgano	copë	2	Në pronësi ose me qera
20	Vibrator betoni	copë	3	Në pronësi ose me qera
21	Tokmak me karburant ose elektrik per ngjeshje	copë	2	Në pronësi ose me qera
22	Pllake vibruese	copë	1	Në pronësi ose me qera
23	Pompe uji	copë	1	Në pronësi ose me qera
24	Pajisje niveluese shtresash	copë	1	Në pronësi ose me qera
25	Depozite uji	copë	1	Në pronësi ose me qera
26	Matrapik	copë	4	Në pronësi ose me qera
27	Kontenier Stacioner (zyre ne objekt)	copë	1	Në pronësi ose me qera
28	Gjenerator / Motogjenerator	copë	1	Në pronësi ose me qera
29	Pompë suvatimi	copë	2	Në pronësi ose me qera
30	Makineri per kthim hekur ndertimi	copë	1	Në pronësi ose me qera
31	Makineri per prerje hekur ndertimi	copë	1	Në pronësi ose me qera
32	Total Station per rilevime matje/azhornime topografike	copë	1	Në pronësi ose me qera
33	Vinç Eskavator	copë	1	Në pronësi ose me qera
34	Sistem pompash Well Point (ekuivalent)	copë	1	Në pronësi ose me qera
35	Fabrike Betoni, pajisur me leje mjedisore nga QKL	copë	1	Në pronësi / me qera ose kontratë furnizimi
36	Skela metalike	m2	750	Në pronësi ose me qera

Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë mjetet dhe pajisjet që disponojnë në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit Nr. 8 të DST.

- a)** Për mjetet në pronësi duhet të paraqitet: dokumenti që verteton regjistrimin e mjetit (leje qarkullimi), plus certifikaten e kontrollit teknik, siguracionin e mjetit (te

vlefshme).

- b)** Për mjetet e deklaruar me qera duhet të paraqitet: kontrata përkatëse noteriale e qerasë e cila duhet të jetë e vlefshme, dokumenti që verteton regjistrimin e tij (leje qarkullimi), plus certifikaten e kontrollit teknik, siguracionin e mjetit, certifikatë për transport mallrash (e vlefshme).
- c)** Për mjetet që nuk shënohen në regjistra publike duhet të paraqiten dokumentat që vërtetojnë pronësinë e tyre, apo marrjen me qira të tij.
- d)** Operatori ekonomik duhet të paraqesë foto për secilin mjet të deklaruar ku të jetë e dukshme dhe targa e mjetit.

Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë mjetet dhe pajisjet që disponojnë në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit Nr. 8 të DST.

Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër, ose t'i kërkojë operatorit sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime, në përputhje me Nenin 26, pika 7, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik".

Operatori/et ekonomik ofertues duhet të deklarojë që të gjitha mjetet dhe pajisjet e përkrahura, do të jenë të angazhuara vetëm në këto kontrata. Mjetet të cilat rezultojnë të angazhuara në kontrata të tjera afati i zbatimit të cilave shtrihet për gjatë afatit të kontratës objekt i prokurimit janë shkak skualifikimi. Autoriteti Kontraktor gëzon të drejtën të verifikojë dhe kontrollojë disponueshmërinë e këtyre mjeteve si gjatë vlerësimit të ofertave ashtu edhe gjatë zbatimit të kontratës.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" dhe nenit 39, pika 6/ç dhe 6/d, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë minimale punëtore, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, si dhe mjetet e pajisjet teknike, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

Për të përcaktuar numrin e mjeteve/makinerive të nevojshme për realizimin e kontratës, janë hartuar analizat teknike, sipas legjislacionit të fushës bazuar në VKM nr. 216, datë 13.4.2023 "Për krijimin dhe funksionimin e sistemit të integruar përinformatizimin e manualit të çmimeve për zërat e punimeve në ndërtim"

Numri dhe lloji i makinerive, paisjeve në pronesi / qira janë vlerësuar si të nevojshme në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës, duke i'u referuar punimeve sipas standardeve, grafikut, kohëzgjatjes së punimeve dhe specifikimeve teknike të projekt zbatimit. Për të zbatuar kontratën, operatorët ekonomikë duhet të përmbushin kapacitetet teknike të pajisjeve dhe aseteve të tjera fizike, për këtë janë përcaktuar edhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin ofertuesit. Nëpërmjet kapaciteteve teknike operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë aftësinë dhe kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, aftësitë organizative. Pajisjet dhe mjetet e mësipërme janë të lidhura ngushtë me objektin e kontratës dhe i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e kapaciteteve dhe të mundësisë së operatorit për përmbushjen me sukses të kontratës si dëshmi për mjetet dhe pajisjet sipas specifikave.

Në të gjitha rastet ku është përmendur fjala markë, Autoriteti Kontraktor do të pranojë edhe "ekuivalentin" e tij/tyre.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente me të dhëna të rreme ose të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike:

Argumentimi i specifikimeve teknike :

Janë sipas të dhënave dhe shënimeve teknike në projektet e zbatimit, relacionet, specifikimet etj. bashkëlidhur DST-ve, të dërguara pranë organit qendror blerës nga Autoriteti Kontraktor perfitues(Drejtoria e Pergjithshme e Arkivave) dhe të hartuara nga projektuesi.

NJESIA E PROKURIMIT